



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U “Nënë Tereza” kërkon të punësojë **1 (një) Përgjegjës Sektori në Sektorin e Auditit**, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:

- Të ketë mbaruar Arsimin e Lartë, profili Ekonomi/Financë/Kontabilitet/Juridik në nivelin Master Shkencor. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Preferohet të ketë eksperiencë pune në Audit.
- Të ketë Çertifikatë Audituesi dhënë nga Njësia Qëndrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik,
- Të ketë njohuri të legjislacionit në fuqi që rregullon profesionin e audituesit si dhe procedurave sipas veprimtarisë që mbulon ky Sektor,
- Të ketë aftësi për të drejtuar punën e stafit nën varësi,
- Të ketë aftësi për të përcaktuar zonat e riskut dhe për ti reflektuar ato në plane strategjike
- Të ketë mbrojtur të paktën një gjuhë të huaj; (preferencë)
- Të njoh shumë mirë procedurat administrative;
- Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara;
- Aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
- Aftësi shumë të mira komunikimi.

Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë:

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV), ne gjuhen shqipe
3. Diplomën/at e arsimit të lartë, të noterizuar/a
4. Çertifikatë Audituesi
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
(<http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/>)
7. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU “Nënë Tereza” duke nisur nga data **30.04.2021 ora 08:00 deri më 14.05.2021 ora 16:30.**

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE